

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit për Monumentet-përmendoret ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 40/08, 40/11 1 2/17) dhe nenit 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", nr. 48/2019 dhe 5/2024), në pajtim me Programin për ngritjen e përmendoreve-memorialeve në Komunën e Ulqinit për vitin 2023 ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - dispozitat komunale", numër 017/23 dhe 05/24), me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Kulturës dhe Mediave të Malit të Zi, Aktvendimi nr. UPI-13-041/24-108/2 i datës 11 qershor 2024, Kuvendi i Komunës së Ulqinit në seancën e mbajtur më 28.10.2024. solli:

VENDIM
për ndërtimin e përmendores me vendosjen e monumentit "Đerđ Kastrioti
Skenderbeg-Gjergj Kastrioti Skenderbeu"

Neni 1

Ngritet përmendorja me vendosjen e monumentit të "Đerđ Kastrioti Skenderbeg – Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (në tekstin e mëtejme: Monumenti), në parcelën nr. 1449/1 KO Ulqin, në qendër të qytetit të Ulqinit, në jug-perëndim të rrethrotullimit në kryqëzimin e bulevardit "Gjergj Kastrioti Skenderbeu", bulevardit "Vëllezërit Frashëri", bulevardit "Nënë Tereza" dhe "Rrugës së Kosovës". Lokacioni më i saktë është hapësira ndërmjet objektit të Komunës së Ulqinit dhe "Rrugës së Kosovës", zonë që tani është e destinuar për parking.

Neni 2

Monumentin nga Neni 1 të këtij vendimi e ngre Komuna e Ulqinit.

Neni 3

Mjetet për ndërtimin e përmendores me vendosjen e monumentit "Đerđ Kastrioti Skenderbeg-Gjergj Kastrioti Skenderbeu" sigurohen nga Komuna e Ulqinit.

Neni 4

Monumenti nga Neni 1 i këtij vendimi do të punohet prej bronzi të derdhur, përmasat a=220-260cm x b=420-460cm x h=240-280cm dhe do të vendoset në një pedestal prej guri natyror, mermer i përpunuar ose i patrajtuar, granit i përpunuar ose të ngjashme, përmasat: a= 180-200cm x b=420-460cm x h=240-280cm.

Neni 5

Në pedestal do të jetë i shkruar teksti i mëposhtëm:
"GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU"
1405-1468"

Neni 6

Afati për ndërtimin e përmendores me vendosjen e monumentit është maji i vitit 2025.

Neni 7

Për mirëmbajtjen e monumentit është e obliguar Komuna e Ulqinit

Neni 8

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen organet administrative dhe shërbimet profesionale të Komunës së Ulqinit, në kuadër të kompetencave të parapara.

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Fletoren Zyrtare të Malit të Zi - Rregulloret Komunale"

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër: 02-016/24-485/3

Ulqin, 28.10.2024

KRYETARJA

Ivana Popović , d.v.